

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Specialist Monitorimi Krujë

Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit

Procedura: PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINE EKZEKUTIVE

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Z. Emirion Zaimi** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Konkurimi

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **19.04.2022** ora **10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **19.04.2022** ora **12:30**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP**, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidateve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në **25 pikë**;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në **60 pike**.

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, nëse kandidati grumbullon më shumë se (mbi 30 pikë e lart), nga vlerësimi me shkrim ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist Monitorimi Krujë**.

Në rastet e kandidateve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **19.04.2022**.

Njoftimi do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **25.04.2022**.

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)